



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0503

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

I B T, Gjakovë, i përfaqësuar nga **M T**, Gjakovë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-15-0358 të datës 02 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 05 tetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-III-15-0358 i datës 02 gusht 2022.**
- 3. Lënda kthehet në rishqyrtim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së, tek gjyqtari përkatës.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 18 qershor 2015, paditësi e dorëzon një padi pronësore në DHPGJS kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, sipas paditësit me numër 34419/2014 të datës 13.08.2014, me të cilin sipas paditësit i është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës se pronësisë për ngastrat vijuese kadastrale :Nr.175, nr.176, nr.177,nr. 425, nr.424, nr.466, nr.426/2,nr.432 dhe nr.442 pa specifikuar zonën kadastrale dhe as sipërfaqet e këtyre ngastrave. Ne padi ai pohon se është pronar 'den baba den ' dhe se prej që ai mban mend edhe stërgjyshi i tij i ka pasur në pronësi këto prona. Në padi ai nuk ka specifikuar bazën juridike në të cilën e mbështet padinë, nuk ka dorëzuar asnjë prove konkrete me këtë padi.

Me datë 03 dhjetor 2021 ,gjyqtari përgjegjës i lendes i Kolegjit të Shkallës së I-rë ka lëshuar një urdhër për paditësin me të cilin nga ai është kërkuar që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të urdhrit ti dorëzoj Gjykatës: Emrin e NSH-së të paditur, dëshminë e ekzistimit të legjitimitetit aktiv për paditësin, dhe të legjitimitetit pasiv për të paditurën nga se nuk është caktuar se cila ndërmarrje shoqërore është pale e paditur, pastaj të dërgoj vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit , të tregoj shkaqet e ankesës ,bazën juridike të kërkesës, faktet në të cilat mbështetet kërkesa si dhe provat që vërtetojnë faktet e kërkesës. Me urdhër po ashtu është kërkuar që paditësi të angazhoj një avokat për mbrojtje të interesave të tij në bazë të nenit 32 të LDHP-së. Në urdhër paditësi ishte paralajmëruar për pasojat ligjore që mund të lindin në rast se nuk plotësohen kërkesat e urdhrit. Ky urdhër është lëshuar në emër të I B T në Gjakovë, e jo në emër të paditësit I B T.

Zyra e regjistrimit në plikon me të cilin është dërguar urdhri ka shënuar emrin e pranuesit I B T. Kjo dërgesë nuk është pranuar as nga paditësi I B T, e as nga person i cekur gabimisht në urdhër I B T.

Ne raportin e postes të dhënë në pliko thuhet se pala është e panjohur dhe ipet data 14.12.2021 në ora 13:30. Në këtë raport të postes jepet edhe një shënim tjetër me datë 16.12.2021 në ora 10:30, se pala gjendet në boten e jashtme.

Pas këtij veprimi të dështuar, gjyqtari përgjegjës i Kolegjit të Shkallës së I-rë e lëshon edhe një urdhër për Zyrën e regjistrimit me të cilin kërkon që urdhri i datës 03.12.2021, të publikohet në tabelën e shpalljeve të Gjykatës, deri sa paditësi ose i autorizuari i tij nuk paraqiten në Gjykatë.

Në bazë të një shënimi zyrtar nga Zyra e regjistrimit të datës 14 prill 2022, vërehet se urdhri është publikuar në tabelën e shpalljeve të Gjykatës nga data 28 mars 2022 e deri në 06 prill 2022.

Me datë 02 gusht 2022, Kolegji i Shkalles së parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-III-15-0358, e hedhë si të papranueshme padinë e paditësit. Shkalla e parë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nga paditësi me Urdhrin e datës 03 dhjetor 2021 është kërkuar që të dërgon në gjykatë: Emrin e NSH-së së paditur, dëshminë e ekzistimit të legjitimitetit aktiv për paditësin, dhe të legjitimitetit pasiv për të paditurën nga se nuk është caktuar se cila ndërmarrje shoqërore është pale e paditur, pastaj të dërgoj vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, të tregoj shkaqet e ankesës, bazën juridike të kërkesës, faktet në të cilat mbështetet kërkesa si dhe provat që vërtetojnë faktet e kërkesës.

Me urdhër po ashtu është kërkuar që paditësi të angazhoj një avokat për mbrojtje të interesave të tij në bazë të nenit 32 të LDHP-së. Në urdhër paditësi ishte paralajmëruar për pasojat ligjore që mund të lindin në rast se nuk plotësohen kërkesat e urdhrit. Pas dështimit të dërgimit të urdhrit të cekur, ky urdhër është afishuar në tabelën e shpalljeve të Gjykatës me datë 28 mars 2022 ,duke konstatuar se paditësi kishte obligimin ligjor të njoftoj Gjykatën me rastrin e ndërrimit të adresës së tij apo të udhëtimit, duke lënë një adresës për komunikimin për Gjykatën. Me qenë se paditësi nuk ka vepruar sipas urdhrit për plotësimin e parashtresës për kërkesën pronësore të tij, ai nuk ka dorëzuar as vendimin e Autoritetit të Likuidimit kundër të se cilit ka paraqitur ankesë. Duke i vlerësuar këto të meta në ankesën e paditësit, Gjykata sipas nenit 35 të LDHP-së lidhur me nenin 99 dhe 253 të LPK-së, padinë është dashtë ta hedh si të pa

pranueshme, duke u bazuar edhe në nenin 36.2.5 lidhur me 2.6 si dhe nenin 74.2 të LDHP-së.

Me datë 1 shtator 2022, paditësi përmes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-III-15-0358 të datës 02 gusht 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim, në mënyrë që të shqyrtohet në merita kërkesëpadia e tij. Për me tepër në ankesë paditësi ka pohuar se lidhur me kërkesën e tij pronësore i është drejtuar Gjykatave të niveleve të ndryshme të cilat janë shpallur jo kompetente, ndërsa AKP-ja e ka refuzuar kërkesën pronësore pa ndonjë bazë duke krijuar situata konfliktuale pasi që mbetet përgjegjësi e Gjykatës për vendimet e lëshuara. Në ankesë ai pohon se ishte pronar i ngastrave lëndore den baba den, dhe se këto pohime mund të vërtetohen me deklaratat e dy dëshmitarëve, H H dhe R Th, dy dëshmitarë të moshuar të lindur dhe me vendbanim në fshatin H. Në ankesë ai pohon se ka prova të mjaftueshme që e mbështet kërkesën e tij, ndërsa Gjykata mund të kërkon ekspertizë gjeodezike lidhur me ngastrat në fjale. Tutje ai pohon se është i pa saktë konstatimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë se gjoja pala ka udhëtuar për në Gjermani, në kohën kur është dërguar urdhri. Tutje ai pohon se vazhdimisht gjendet në shtëpi në fshatin H, dhe se nuk ka pasë asnjë vize për të udhëtuar në Gjermani. Tutje në ankesë ai pohon se për shkak të mungesës së mjeteve nuk ka angazhuar avokat, mirëpo tani e tutje ai pohon se në procedurë do të përfaqësohet nga M T.

Me datë 20 tetor 2022, paditësi e dorëzoi në DHPGJS edhe një parashtresë me të cilën ai pohon se e plotëson ankesën e tij me prova të reja lidhur me ngastrat lëndore. Në këtë parashtresë ai i përsërit shumicën e pretendimeve të cekur në ankesë. Bashkë me këtë parashtresë ai ka dorëzuar: një kërkesë për njohjen e pronësisë drejtuar AKP-së me datë 05.10.2016, një kopje të padisë dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë me vulë të pranimit të pa lexuar, një deklaratë të dy dëshmitareve ,Historiatin e ngastrave ,një skicë të ngastrave ,një kërkesë për devijim të shtyllës elektrike drejtuar K në Prishtinë, një kërkesë për ndalim të

menjëhershëm të punimeve, drejtuar disa zyrtareve në Komunën e Gjakovës, një kallëzim penal, një kopje të përgjegjje të Drejtorisë për Punë Inspektuese, kopje të kërkesës për korrigjim të gabimit në projektin ' M I', drejtuar Komunës së Gjakovës, kopje të kërkesës për rregullimin-nivelizim të një segmenti rrugore drejtuar Kryetarit të Komunës, një kopje të përgjegjje se Komunës në këto kërkesa të datës 26 prill 2021, dhe disa foto për ngastrat e pretenduara.

Me datë 07 nëntor 2022 , AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së ankuesit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se ajo e mbështet në tërësi Aktvendimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit si të pabazuara. AKP-ja në përgjigje në ankesë pohon se nuk do t'i përsërisë argumentet edhe më herët gjatë mbrojtjes në padi, pasi që kjo do të jetë e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Andaj nga këto arsye, AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë me datë 18 qershor 2015, e ka kontestuar një vendim të Autoritetit të Likuidimit që sipas paditësit është me numër 34419/2014 të datës 13.08.2014.

Me këtë vendim sipas paditësit është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrat lëndore të ankesës. Me këtë ankesë nuk është dorëzuar asnjë provë materiale, madje as vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se gjyqtari përgjegjës i lëndës i Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, e ka lëshuar një urdhër me të cilin është kërkuar nga paditësi ka plotësoj ankesën e tij me të dhënat vijuese: të dërgoj emrin e NSH-së së paditur, dëshminë e ekzistimit të legjitimitetit aktiv për paditësin dhe të legjitimitetit pasiv për të paditurën, nga se nuk është caktuar se cila ndërmarrje shoqërore është palë e paditur, pastaj të dërgoj vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, të tregoj shkaqet e ankesës, bazën juridike të kërkesës, faktet në të cilat mbështetet kërkesa, si dhe provat që vërtetojnë faktet e kërkesës. Me urdhër po ashtu është kërkuar që paditësi të angazhoj një avokat për mbrojtje të interesave të tij në bazë të nenit 32 të LDHP-së. Në urdhër paditësi ishte paralajmëruar për pasojat ligjore që mund të lindin në rast se nuk plotësohen kërkesat e urdhrit.

Ky urdhër është lëshuar gabimisht në emër të I B T nga fshati H Gjakovë, e jo në emër të paditësit, I B T. Urdhri me emrin e tillë të gabuar është dërguar nga Zyra e regjistrimit për personin I B T.

Ky urdhër nuk është pranuar as nga paditësi, I B T e as nga person në emër të se cilit ishte dërguar urdhri I B T.

Raporti i postes i datës 14.12.2021, ishte se pala është e pa njohur, ndërsa në këtë pliko ekziston raporti vazhdues i postës i datës 16.12.2021, se pala gjendet në boten e jashtme.

Pas dështimit të dorëzimit të urdhrit, gjyqtari përgjegjës i Shkallës së I-rë e lëshon edhe një urdhër me datë 24 mars 2022, për Zyrën e regjistrimit duke urdhëruar që urdhri të publikohet në tabelën e shpalljeve të Gjykatës. Në bazë të shënimit zyrtar që ekziston në dosje, ky urdhër është publikuar në tabelën e shpalljes nga data 28 mars 2022 e deri me 06 prill 2022.

Kolegji i Apelit vëren se Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë me të cilin ankesa e paditësit është hedh poshtë si e pa pranueshme, është pranuar nga paditësi në adresën e tij në fshatin H në Gjakovë.

Kolegji i Apelit vëren se në këtë rast, Kolegji i Shkallës së I-rë ka bërë lëshime dhe pa rregullsi që kanë ndikuar që urdhri të mos dorëzohet si duhet tek paditësi. Fillimisht në urdhër ishte shënuar emëri i gabuar I B T, e jo emri i paditësit.

Për këtë lëshim të Gjykatës, nuk ka mundësi të pësoj pala paditëse. Duke qenë se urdhri nuk ishte dërguar në emër të paditësit, por në emër të një personi tjetër, edhe publikimi i tij përmes tabelës së shpalljes, nuk konsiderohet si veprim procedural i ligjshëm dhe si dorëzim i rregullt i urdhrit.

Në këtë rast nuk mund të bëhet fjalë as për ndërrim të adresës, siç konstaton në mënyrë të gabuar Kolegji i Shkallës së I-rë, pasi që paditësi nuk e ka ndërruar vendbanimin e tij. Paditësi Aktvendimin e ankimuar e ka pranuar në të njëjtën adresë të dhënë në padi.

Prandaj nga këto arsye, duke qenë se nuk mund të bëhet fjalë për dorëzim të rregullt dhe ligjor të urdhrit, Kolegji i Shkallës së I-rë nuk ka pas bazë ligjore që me Aktvendimin e ankimuar, ta hedh padinë si të pa pranueshme, për faktin që paditësi asnjëherë nuk e ka pranuar urdhrin, dhe ai nuk ka qenë i njoftuar me kërkesat e urdhrit dhe as me pasojat ligjore që dalin me mos plotësim të urdhrit.

Andaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konsideron se ankesa e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar, të anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim tek gjyqtari përkatës.

Në këtë lëndë Gjyqtari përkatësi i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duhet ta përsërit edhe njëherë lëshimin e një urdhri të ri me kërkesa të njëjta, në emër të paditësit në adresën e tij, dhe pastaj varësisht nga gjendja procedurale që krijohet pas lëshimit të Urdhrit, të vazhdon me veprimet tjera gjatë shqyrtimit ankesës.

Prandaj nga se u tha më sipër, në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 03 tetor 2022, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit me 05 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
